



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT  
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 8778/2 Prot.

Tiranë, më 10.01.2021

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1784, datë 19.11.2015.

**SHOQËRISË “MINING VENTURES ALBANIA” SH.P.K**  
**Rruga “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, Kati 8/3, Tiranë**

**Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**  
**Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA**  
**Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “MINING VENTURES ALBANIA” sh.p.k, e cila është zotëruese e Lejes Minerare të shfrytëzimit Nr.1784, datë 19.11.2015, për mineralin Gëlqeror i Mermerizuar, në objektin “Melovë”, Bashkia Skrapar, Qarku Berat.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.4621, datë 06.12.2021, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.8778, datë 07.12.2021, është propozuar revokimi i Lejes së Shfrytëzimit Nr.1784, datë 19.11.2015, për mineralin Gëlqeror i Mermerizuar, në objektin “Melovë”, Bashkia Skrapar, Qarku Berat, sepse ka ndërprerë veprimtarinë minerare pa njoftuar më parë strukturat përgjegjëse për veprimtarinë minerare.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe ndryshimet e tij Nr.134/2014 datë 09.10.2014.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen minerare të shfrytëzimit Nr.1784, datë 19.11.2015, për mineralin Gëlqeror i Mermerizuar, në objektin “Melovë”, Bashkia Skrapar, Qarku Berat, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit Nr.1784, datë 19.11.2015, për mineralin Gëlqeror i Mermerizuar, në objektin “Melovë”, Bashkia Skrapar, Qarku Berat.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**BELINDA BALLUKU**  
**ME AUTORIZIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ILIR BEJTJA**

